KRONIKË E ZEZË

Ndihmonin fëmijët të gjuanin me armë, Policia ua konfiskon ato dhe i liron

2 janar 2023, 18:20

Shpërndaje në

Policia e Kosovës ka njoftuar së të hënën në Prizren ka konfiskuar tri armë.

Armët janë sekuestruar nga personat e dyshuar, të cilët më datën një janar, rreth orës 00:05, kanë publikuar video në rrjetet sociale, duke shkrepur me armë zjarri. Sipas njoftimit të Policisë ata janë parë duke i ndihmuar edhe disa fëmijë që të gjuanin më armë.

"Me datë 01.01.2023 në ora 00:05 nëpërmes rrjeteve sociale është parë një video ku shihen disa persona të dyshuar duke shkrepur me arme zjarri, të cilët gjithashtu ndihmonin disa fëmijë që të gjuajnë me armë", thuhet në njoftim.

Sipas Policisë të dyshuarit kanë deklaruar se kanë shkrepur me armë për të festuar me rastin e ndërrimit të viteve.

"Pasi që policia ka marr informacionin ka filluar hetimet, pas veprimeve operative hetimore është arrit që të dyshuarit të identifikohen dhe të lokalizohen. Në orët e paradites policia ka shkuar në vendngjarje, të shtëpia e të dyshuarve, katër të dyshuarit, pasi që janë përball me provat kanë pranuar veprën dhe i kanë dorëzuar armët", thuhet në njoftimin e Policisë.

Sipas njoftimit të dyshuarit pasi që janë intervistuar janë liruar me procedurë të rregullt.

"Nga policia janë sekuestruar tri armë, një pushkë automatike dhe dy pistoleta me gjithë karikator dhe municion", thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#POLICIA #KONFISKON #TRI ARME #PRIZREN #NDIHMONIN #FËMIJËT #GJUANIN

Gjendet i vdekur një burrë në Podujevë
Digjen tri vetura në Pejë
Katër të lënduar në një aksident në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë
Kapet i burgosuri që u arratis derisa po transportohej për në Gjykatë
U rrahën mes vete, burrë e grua shoqërohen në stacionin policor
Një person vdes në aksident, ra në lumin Ibër në rrugën Leposaviq-Mitrovicë
Dyshohet se falsifikoi datën e vizës, lirohet në procedurë të rregullt

Taboola Feed

Apartamentet në Hong Kong mund t'ju habisin
Kërko reklama | Sponsored
Mëso më shumë

Online Design Courses May Get You A Job Sooner Than You Think!
Online Design Courses | Search Ads | Sponsored

Sulmohet një grua në Prishtinë nga tre persona
Një grua në Prishtinë ka raportuar se pas një mosmarrëveshje është sulmuar fizikisht nga tre burra. Policia ka thënë se ngjarja ka ndodhur në rrugën "Fahri Faziliu" të shtunën në ora …
Kohanet

Starting A Business In Dubai Might Be Easier Than You Think
Start your business today
Start Business In Dubai I Search AD | Sponsored
Search Now

TË TJERA

Në Mitrovicë arrestohet i dyshuari që kanosi me jetë gruan e tij

Vjedhje e rëndë në Ferizaj, hajnat në arrati

Vrasja në Prizren dyshohet se ndodhi për shkak të një fature

Ferizaj, arrestohet një person për rrahjen e ish-bashkëshortes 23-vjeçare

KOHA
Marketing Politika e privatësisë Kushtet e përdorimit +383 (0) 38 249 105 info@koha.net
Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë
Partnerët: Shkabaj

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qofshë origjinal apo i modifikuar në çfardo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internet a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.